

V E N D I M

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me date 30 Prill 2007, une Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, Altina Xhoxhaj, mora ne shqyrtim kerkesen dhe aktet e paraqitura nga kerkuesi Ardian Shehu, administrator i shoqerise "Pronet Albania" shpk dhe

K O N S T A T O V A

Se kerkuesi Ardian Shehu eshte administrator i shoqerise "Pronet Albania" sh.p.k, e themeluar nga ortaku i vetem, shoqeria kosovare "Pronet", sipas aktit te themelimit dhe statutit te nenshkruar prej tij.

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rr. "Brigada VIII", No.2/4.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, i zoteruar 100 % nga ortaku i vetem shoqeria kosovare "Pronet", e regjistruar ne Regjistrin e Biznesit Kosovar me nr. 70041518, prane Ministrise se Tregtise dhe Industrise te Qeverise se Kosoves

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte mbi 20 vjet.

Administrator i shoqerise eshte z. Ardian Shehu.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne fushen e: Keshillime dhe sigurimi i zgjidhjeve programore-software, tregeti me shumice e pajisjeve informatike per zyra, sherbime konsulence dhe sherbime te tjera ne fushen e teknologjise se informacionit.

Pasi shqyrtova kerkesen, aktin e themelimit dhe statutin e paraqitur nga kerkuesi konstatoj se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje të Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", dhe Ligjit nr. 7667 date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar".

V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik të shoqerise me pergjegjesi të kufizuar me emertimin "Pronet Albania" shpk.

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rr. "Brigada VIII", No. 2/4.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, i zoteruar 100 % nga ortaku i vetem "Pronet" sh.p.k e regjistruar ne Regjistrin e Biznesit Kosovar me nr. 70041518, prane Ministrise se Tregtise dhe Industrise se Qeverise se Kosoves..

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqerise eshte mbi 20 vjet.


Administrator i shoqerise eshte z. Ardian Shehu.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne fushen e: Keshillime dhe sigurimi i zgjidhjeve programore-software, tregeti me shumice e pajisjeve informatike per zyra, sherbime konsulence dhe sherbime te tjera ne fushen e teknologjise se informacionit.


Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

G J Y Q T A R E

ALTINA XHOXHAJ

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Altina Xhoxhaj', written over a circular stamp or seal.

SHOQERIA TREGTARE
Me Përgjegjësi të Kufizuar
"Pronet Albania" shpk



AKT THEMELIMI

Ne Tirane, sot me daten 07.04.2007, shoqeria Kosovare me përgjegjësi të Kufizuar "Pronet", e regjistruar ne Regjistrin e Biznesit Kosovar, prane Ministrise se Tregtise dhe Industrise te Qeverise se Kosoves me nr. regjistri 70041518 duke u bazuar ne :

Vendimin e asamblese se ortakëve dhe iniciativën e lire private,

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,

Ne ligjin 7638 date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare ",

Ne ligjin nr. 7667 date 28.01.1993, " Per regjistrin tregtar ", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me ortak të vetem me përgjegjësi të kufizuar, "Pronet Albania" shpk, Tirane, Shqiperi.

NENI 1

Shoqeria tregtare, formohet nga ortaku i vetem "Pronet" sh.p.k, me emertimin "Pronet Albania " shpk Tirane, emer i cili do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e shoqerise "Pronet Albania" shpk eshte ne Tirane, Rruga Brigada VIII, No. 2/4.

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

NENI 4

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (njeqindmije) , formuar dhe nensakruar nga ortaku i vetem, i ndare ne 100 kuota, me vlere nominale 1 kuote / 1000 leke, i depozituar sipas ligjit.

Ortaku i vetem ka pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 5

Kapitali nuk mund të jete kurre i perfaqshuar me letra me vlere dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqerise, behet para kerkeses se drejtuar Gjykates per njohjen dhe rregjistrimin e saj si person juridik.

NENI 6

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është mbi 20 vjet, duke filluar ky afat nga dita e shpalljes së Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

NENI 7

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 8

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në këto drejtime:

Keshillime dhe sigurimi i zgjidhjeve programore-software, tregeti me shumicë e pajisjeve informatike për zyrë, shërbime konsulence dhe shërbime të tjera në fushën e teknologjisë së informacionit.

NENI 9

Ortaku i vetëm është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji "Për shoqëritë tregtare" i njeh amblese së ortakëve që janë krijuar me ortakëri.

Ortaku i vetëm mund t'ia delegoj kompetencat një ose me shumë administratorëve të caktuar prej tij ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokures.

NENI 10

Administratori i shoqërisë "Pronet Albania" shpk, emërohet z. Ardian Shehu.

NENI 11

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplare, vetëm në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike dhe ai është i vlefshëm kur në të gjithë faqet e tij është vënë emri, mbiemri dhe firma origjinale e ortakës themeluesë dhe kur vertetimi i autenticitetit të nënshkrimit është bërë nga Noteri.

Per ortakët e shoqërisë "Pronet"
Administratori i shoqërisë "Pronet Albania" sh.p.k

Ardian Shehu




REPUBLICA E SHQIPËRISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 3050 Rep.

Nr. — Kol.



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 07.04.2007, para meje Noteres Publike, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht shtetasja me keto identitete :

Ardian Shehuaaj, i biri i Nexhmedinit, dhe i Nesries, i dtl.1973, administrator i shoqerise "Pronet Albania " shpk, me nr. pasaporte K0040410, me nr. Personal 1011044367.

Shtetesi eshte madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Me vullnetin e tij te lire e te plote dhe te singerte ka redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, me cilesine e administratorit te shoqerise "Pronet Albania" shpk, aktin e themelimit te shoqerise "Pronet Albania" sh.p.k te perbere nga 11 nene dhe pasi e lexoi ate e nenshkroi pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale te tij ne kete zyre dhe para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj te kesaj kerkese si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.

NOTERE

NOTERJA
E NOTERES
PUBLIKE
TIRANE
ME DATEN
07.04.2007

SHOQERIA TREGATRE
Me pergjegjesi të kufizuar
"Pronet Albania" shpk



STATUTI

KREU I

EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA

NENI 1

Ne Tirane, sot me daten 07.04.2007, shoqeria Kosovare me pergjegjesi te Kufizuar "Pronet", e regjistruar ne Regjistrin e Biznesit Kosovar, prane Ministrise se Tregtise dhe Industrise te Qeverise se Kosoves me nr. regjistri 70041518 krijon shoqerine tregtare, me ortak të vetem me pergjegjesi të kufizuar, "Pronet Albania" shpk, Tirane, Shqiperi.

NENI 2

Shoqeria tregtare eshte vendase dhe quhet me emrin "Pronet Albania" shpk Tirane, emertim i cili do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 3

Selia e shoqerise "Pronet Albania" shpk eshte ne Tirane, rruga Brigada VIII, Nr 2/4.

NENI 4

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikës se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (njqindmije), formuar dhe nenshkruar nga ortaku i vetem, i ndare ne 100 kuota, me vlere nominale 1 kuote / 1000 leke, i depozituar sipas ligjit, ku nje kuote eshte e barabarte me nje vote vendimore.

Ortaku i vetem ka pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 6

Kapitali nuk mund të jete kurre i perfaqshuar me letra me vlere dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqerise, behet para kerkeses se drejtuar Gjykates per njohjen dhe rregjistrimin e saj si person juridik.

NENI 7

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është mbi 20 vjet, duke filluar ky afat nga data e shpalljes së Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

Me vendim të Ortakut të vetëm, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Gjykatës kompetente për të bërë shenimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

NENI 8

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në këto drejtime:

Keshillime dhe sigurimi i zgjidhjeve programore-software, tregeti me shumicë e pajisjeve informatike për zyra, shërbime konsulence dhe shërbime të tjera në fushën e teknologjisë së informacionit.

NENI 9

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e shpalljes së Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate. Ushtrimin e Aktivitetit tregtar e fillon pasi të jetë regjistruar dhe paisur me certifikatat përkatëse në Organin e Tatimit Fiskal Tiranë.

NENI 10

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe ato Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore specifike për ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarisë së saj, mbi bazën e Aktit të Themelimit dhe Statutit të saj dhe normat e së drejtës tregtare ndërkombëtare.

KREU II

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11

Shoqëria cel llogari bankare në lekë vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

NENI 12

Pjesët e kapitalit themelor, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil dhe atij Tregtar. Ortaku i vetëm ka të drejtë të transferoj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht kontributet e saj përfshirë dhe fondet e Kontributet në natyrë.



Transferimet e pjeseve të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me akt noterial dhe per nje gje të tille ortakut i vetem duhet të marre paraprakisht vendim me shkrim. Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sapo tu behen të ditura.

NENI 13

Kapitali Themeltar i shoqerise mund të rritet ose zvogelohet, mbi bazen e vendimit me shkrim që merr ortakut i vetem, i cili nenshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bere dhe shenimet ne regjistrin perkates.

Me vendim të Ortakut te vetem ajo ka të drejten qe nje pjese të kuotave të kapitalit themeltar t'ja tjetersoje nje apo disa personave fizike jashte ortakerise ose personave juridike, vendas apo të huaj mbi bazen e aktit noterial, duke ju ceduar atyre dhe të drejten e qenies ortak ne raport me pjesen e kuotave të kapitalit të tjetersuar.

Cdo vendim i ortakës se vetem per ndryshimin e kapitalit themeltar i dergohet menjehere Gjykates kompetente qe e ka njohur dhe rregjistruar shoqerine si person juridik.

KREU III

ORGANET DREJTUESE TË SHOQERISE DHE TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT TË VETEM

NENI 14

Ortakut i vetem eshte Organi me i Larte Drejtues dhe Vendimor i shoqerise dhe ai ushtron të gjithë kompetencat qe ligji " Per shoqerite Tregtare " i njej asamblese se ortakëve qe jane krijuar me ortakeri.

Ortakut i vetem mund t'ja delegoje kompetencat nje ose me shume administratoreve të caktuar prej tij ose dhe nje peronë fizik jashte ortakerise se shoqerise.

NENI 15

Me vendim të ortakut te vetem shoqeria mund të zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortakë të tjere, shtetase shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me nje shoqeri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashte shtetit.

NENI 16

Ortakut i vetem e shoqerise ka dhe keto të drejta dhe detyra kryesore :

Të marre pjese ne drejtimin dhe administrimin e gjithanshem të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise dhe të cdo veprimtarie tjetër të saj, kur ajo ushtrohet ne perputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

Të kerkoje dhe t'i jepen të gjitha informatat qe kane të bejne me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarise se shoqerise, si dhe i të gjitha dokumentave të perpunuara nga shoqeria, ato qe kane të bjene me nxjerrjen e rezultatit ekonomik të bilancit kontabel apo per cdo llogari të cclur si dhe të asaj likuiduese dhe asaj rrjedhese.

Të marre pjese ne rezultatet e veprimtarise se Shoqerise ne cfaredo forme apo sasi, sipas kontributit të dhene prej tij.



Të kryejë shërbime për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të veprimtarisë së rregullt ligjore të Shoqërisë.

Emëron dhe shkarkon në çdo kohë administratorin e shoqërisë, cakton ekspertin kontabel të autorizuar. Ekspertin kontabel të autorizuar e ngarkon për përgatitjen dhe nxjerrjen e bilancit vjetor ekonomik-financiar të aktivitetit të shoqërisë, të cilin ia paraqesin ortakët mbi bazën e raportit me shkri dhe pas shqyrtimit të tij, ortakët i vetëm ka dhe të drejtën e miratimit vendimor të këtij bilanci.

Nxjerrja e bilancit financiar vjetor mbi bazën e të dhënave të kontabilitetit, bëhet brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Ortakët i vetëm kryesisht si dhe Administratori i emëruar prej tij, ushtrojnë dhe këto të drejta:

Mundësohen për të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike që konsiderohen se janë të domosdoshme për ushtrimin e gjithanshëm dhe fitimprurës të veprimtarisë tregtare të shoqërisë sipas qëllimeve dhe objektivave të saj sic mund të jenë:

1. Të lidhin kontrata të ndryshme që kanë për objekt blerjen, shitjen, këmbimin, marrjen me qera të pasurive të ndryshme (të luajtshme apo të paluajtshme), si me persona fizik dhe ata juridikë, vendas apo të huaj si dhe me shtetin dhe në rast të blerjes së pasurive të paluajtshme, të bëjnë dhe transkriptimin e pronësive së saj në favorin e tyre në Hipotekën e ZRPP, për të dokumentuar një rrethane të tillë dhe si shtesë të kapitalit në natyrë.
2. Të kryejë çdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave private dhe shtetërore, Bankat e çdo niveli etj. që kanë të bëjnë me Garancitë, sipërmarrjet, marrjen e kredive, sigurimeve, transportit (brenda dhe jashtë shtetit), për zhdoganimin e mallrave të importuara apo eksportuara, atë të plotësimit me korektëse të dokumentacionit fiskal e tatimor etj. e shlyerjes në kohë të çdo detyrimi. Në rastet kur këto veprime juridike kryhen nga administratorei i emëruar nga ortakët i vetëm ose personi që e përfaqëson atë mbi bazën e prokurës, këta në përfundim të realizimit të veprimit përkatës detyrohen që të njoftojnë menjëherë dhe t'i japin llogari ortakët të vetëm.
3. Administratorei ose përfaqësuesi me prokurë janë individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë apo të tretëve, për veprime të kryera në shkelje të ligjeve dhe që bien në kundërshtim me këtë Statut dhe për dëmin e shkaktuar me faj, sipas rastit, ortakët i vetëm mund të ngrejë dhe të kërkojë ndaj tyre padi për shlyerjen e dëmit civil, duke përfshirë dhe të drejtën për të bërë kallzim për ndjekje penale në Prokurorinë e juridiksionit tokësor ku ka selinë shoqëria.

NENI 17

Përfaqësimi i shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët si brenda dhe jashtë shtetit i përket Administratorit, i cili është z.Ardian Shehu.

NENI 18

Ortakët i vetëm dhe administratori i shoqërisë, kanë të drejtë që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të shoqërisë, të marrin në punë shtetase të ndryshëm, madhore dhe me zotësi të plote për të vepruar, duke lidhur kontrata sipas kriterëve që parashikohen në Kodin e Punës në fuqi të miratuar me ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 dhe me ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 " Për sigurimet shoqërore " si dhe në përshatje me rregullat e brendshme të disiplinës teknike dhe të punës të caktuara nga vete punëdhënësi.



KREU IV

BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 19

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqerise, mbyllen me datën 31 Dhjetor të çdo viti. Për nxjerrjen e rezultatit kontabel të shoqerise, mbi bazën e aktivitetit dhe pasivitetit ngarkohet nga ortakut i vetëm një ekspert kontabel i autorizuar.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqerise, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.

Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut të vetëm për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ai ka.

NENI 20

Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bërë me saktësi dhe duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen në Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, që janë të detyrueshme për tu zbatuar nga çdo subjekt privat, që ushtron veprimtari tregtare.

NENI 21

Bilanci Kontabel Vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortakut i vetëm, në të cilin ai jo vetëm që dokumenton miratimin e tij por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshëm të shoqerise dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

NENI 22

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimit e pagesave ndaj të treta, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi, ortakës së vetëm të shoqerise.

NENI 23

Shpërndarja ose prishja e shoqerise mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar sic mund të jete :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimet të metejshëm të veprimtarisë së saj.
- b) Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji " Për Falimentimin e Shoqerive Tregtare "
- c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këtë rast ortakut i vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë " Shoqeri në likuidim e sipër ".



NENI 24

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrit Tregtar.

NENI 25

Likuidatori eshte i detyruar qe të jete i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetaseve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

NENI 26

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortaku ivetem duhet ta zgjidh ne mirekuptim, ne të kunderten ceshtjen mund të beje objekt konflikti gjyqsor ne Gjykates e Shkalles se Pare Tirane.

NENI 27


Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet udhezimeve plotesuese dhe të ligjshme të dhena nga ortaku i vetem si dhe legjislacioni ne fuqi.

NENI 28

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridik, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nenshkruhet nga une drejtori menaxhues i deleguar i shoqerise Pronet, ortak i vetem themelues i shoqerise tregtare "Pronet Albania" shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen time orgjinale, autenticiteti i të cilave vertetohet nga Noteri.

**Per ortaket e shoqerise Pronet
Administratori i shoqerise "Pronet Albania" sh.p.k**

Ardian Shehu




REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 305C Rep.

Nr. — Kol.



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 07.04.2007, para meje Noteres Publike, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht shtetasja me keto identitete :

Ardian Shehuaj, i biri i Nexhmedinit, dhe i Nesries, i dtl.1973, administrator i shoqerise "Pronet Albania " shpk, me nr. pasaporte K0040410, me nr. Personal 1011044367.

Shtetesi eshte madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Me vullnetin e tij te lire e te plote dhe te singerte ka redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, me cilesine e administratorit te shoqerise "Pronet Albania" shpk, statutin e themelimit te shoqerise "Pronet Albania" sh.p.k te perbere nga 28 nene dhe pasi e lexoi ate e nenshkroi pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale te tij ne kete zyre dhe para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj rregulisine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj te kesaj kerkese si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.


NOTERE

NOTER
MARGENACHIA
TEL: 069 21 21 60

KERKESE

B. A. Xho Xhey
dt. 23.04.2007

23 APR. 2007

**PER REGISTRIMIN SI PERSON JURIDIK**

KERKUES: Ardian Shehu, i biri i Nexhmedinit, dhe i Nesries, i dtl.1973, shtetas i huaj, administrator i shoqërisë "Pronet Albania" sh.p.k.

OBJEKTI : Rregjistrimin si person juridik të shoqërise “ Pronet Albania ” shpk.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare " dhe ligji 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar ".

DREJTUAR

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

I nderuar z/zj. Kryetar !

Une kerkuesi Ardian Shehu, administrator i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Vronet Albania" shpk parashtroj se është krijuar shoqëria e mesipërme e themeluar nga:

Ortak i vetem i shoqerise eshte shoqeria e huaj me pergjegjesi te kufizuar Prodet, e regjistruar ne Regjistrin e Biznesit Kosovar, prane Ministrise se Tregtise dhe Industrise te Reperise se Kosoves me nr. regjistri 70041518.

Administrator i shoqerise eshte z. Ardian Shehu.

Kapitali 100.000 leke i depozituar prane Union Bank, Shqiperi, sipas mandatit bashkengjitur.

Selia qendrore e shoqerise eshte ne Kruga Brigada 8, Nr. 2/4, Tirane.

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë është mbi 20 vjet.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj sipas aktit të themelimit dhe statutit të nënshkruar nga ortaku i vetëm.

Bashkëlidhur me kete kerkese dergohen te noterizuar Akti i Themelimit, Statuti i Shoqerise, vendimi i asmblesë se ortakëve te shoqerise Pronet per themelimin e shoqerise "Pronet Albania", akte qe vertetojne se shoqeria Pronet nuk eshte ne proces falimentimi dhe nuk ka detyrime te pashlyera latimore si dhe akte te tjera dokumentare qe vertetojne kapitalin e shoqerise të nënshkruar.

Me besimin se kërkesa ime ligjore do të merret në konsideratë dhe pranohet.

Ju faleminderit per mirekuptimin.

ADMINISTRATOR

Ardian Shehu

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 3050 Rep.

Nr. — Kol.



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 07.04.2007, para meje Noteres Publike, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht shtetasja me keto identitete :

Ardian Shehuaj, i biri i Nexhmedinit, dhe i Nesries, i dtl.1973, administrator i shoqerise "Pronet Albania " shpk, me nr. pasaporte K0040410, me nr. Personal 1011044367.

Shtetesi eshte madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Me vullnetin e tij te lire e te plote dhe te sinqerte ka redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, me cilesine e administratorit te shoqerise "Pronet Albania" shpk, kerkesen drejtuar Gjykates se Shkalles se pare Tirane, per regjistrimin si person juridik te kesaj shoqerie tregtare dhe pasi e lexoi ate e nenshkroi pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale te tij ne kete zyre dhe para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj te kesaj kerkese si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.

NOTERE

N. 11111111
MARGENA ÇEZZ
07.04.2007 21:21:02



INSTITUCIONET E PËRKOSSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA
MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO



VËRTETIM POTVRDA VERIFICATION

Regioni/Region: **NJ T MEDHEN**

NRB/BRB/NIT: **70041518**

Tatimpaguesi/Poreznik/Taxpayer: **„Pronet” IT K.I.T., Sh.p.k.**

Pronari/Vlasnik/Owner: **Valon Budima**

Adresa/Adresa/Address: **Dardania-Bill Clinton**

Vendni/Mesto/Place: **Prishtinë**

Komuna/Opština/Municipality: **PRISHTINË**

Ka deklaruar dhe ka paguar obligimet tatimore dhe nuk figuron si debitor (borxhli) pranë Administratës Tatimore të Kosovës. Ky vërtetim nuk e përjashton mundësinë e kontrollit të mëvonshëm për verifikimin e saktësisë së detyrimeve tatimore për periudhat tjera tatimore.

Deklarisao i vršio naplatu poreskih obaveza i nije u listu dužnika Poreske Administracije Kosova. Ova potvrda ne isključuje mogućnost kasnije kontrole radi tačne provere poreskih obaveza za druge poreske periode.

Has filed and paid tax liabilities and it does not appear as debtor on the Tax Administration of Kosovo. This verification does not avoid the possibility of audit sometimes later to check the correctness of tax liabilities for other tax periods.

Vërtetimi i lëshohet tatimpaguesit me kërkesen e datës: **21-03-2007**

Potvrda se izdaje na zahtev poreskog obveznika:

The verification is issued upon taxpayer's request of:

Arsyeja e lëshimit: **Hapja e filjalet ne Tiranë**

Potvrda se izdaje radi:


Reason of issuance:

Vërejtje:

Napomena:

Note:

21-03-2007





PRONET

Zona Industriale, Veternik pn, Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 55 77 99 · Fax: +381 38 542 393
www.pronet-ks.com · sales@pronet-ks.com
Nr. Regj. 70041518



Vendim mbi hapjen e kompanisë në Tiranë – Shqipëri

Prishtinë, 5 Mars 2007

Pronet IT Konsallting, Inxhiniering dhe Telekomunikime (shkurt: Pronet), me seli në Prishtinë, Kosovë dhe me numër të regjistrimit 70041518, merr vendim që të hapë kompani të re në Shqipëri.

1. Kompania që do të hapet është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
2. Pronar i vetëm i kompanisë është Pronet
3. Emri i kompanisë do të jetë “Pronet Albania”
4. Kapitali i shoqërisë është 100,000 Lekë
5. Selia e kompanisë është në Rruga Brigada e VIII 2/4, Tiranë
6. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:
 - Këshillime dhe sigurim i zgjidhjeve programore – softuer
 - Tregtia me shumicë e makinave për zyre dhe pajisjeve informatike
 - Ofrimi i konsulencës dhe shërbime tjera në fushën e Teknologjisë Informatike
7. Administratori i shoqërisë është Z. Ardian Shehu

Ardian Me këtë dokument ngarkohet Administratori/Drejtori Menaxhues i Pronet të nënshkruajë statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë dhe kërkesën e drejtuar Gjykatës para Noterit në Tiranë, për llogari të Pronet, si dhe të caktojë avokat për ndjekjen e procedurës së regjistrimit të shoqërisë në Gjykatë, organet e tatim taksave dhe në Bashki.

Të dhënat personale për Z. Ardian Shehu:

Nr i pasaportës: K004104, lëshuar nga UNMIK Prishtinë

Data e lindjes: 30 Maj 1973

Vendi i lindjes: Prishtinë


REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 3038 Rep.

Nr. _____ Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI



Ne Tirane, sot me date 07.04.2007, para meje Noteres Publike, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht shtetasit me keto identitete :

Valon Budima, i biri i Muhamedit dhe i Kimetes, i dtl.1972, ortak i shoqerise "Pronet" shpk, me nr. pasaporte K0009846, me nr. Personal 2015637717.

Armend Skeja, i biri i Salaudinit, dtl 1968, ortak I shoqerise "Pronet" sh.p.k, me nr. Personal 1015780076.

Shtetesit jane madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Me vullnetin e tyre te lire e te plote dhe te singerte kane redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, me cilesine e ortakeve te shoqerise "Pronet Albania" shpk, vendimin e asamblese se ortakeve per themelimin e shoqerise "Pronet Albania" sh.p.k. dhe pasi e lexuan ate e nenshkruan pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale te tyre ne kete zyre para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj te kesaj kerkese si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
01.04.2007
01.04.2007

VERTETIM

Vertetojme se **"PRONET ALBANIA NE KRIJIM"** SHPK ka hapur llogari ne lek prane UNION BANK me numer 111110077150110 Llogaria eshte bllokuar si fond per kapital fillestar per krijimin e shoqerise **"PRONET ALBANIA"** SHPK

Gjendja e llogarise ne daten e sotme eshte 100,000 leke (Njeqind mije)

Firmat e autorizuar te bankes:



Erovena SHAMKU
Menaxhere e Sherbimit me Klientet

A handwritten signature in black ink, which appears to be 'Eglantina ZOGU'.

Eglantina ZOGU
Specialiste e Sherbimit me Klientet

**INTERIM ADMINISTRATION OF KOSOVO
ADMINISTRATA E PËRKOHSHME E KOSOVËS
PRIVREMENA ADMINISTRACIJA KOSOVA**

**GJYKATA EKONOMIKE E QARKUT
AGJ.NR. 203/07
DATA 05.03.2007
PRISHTINË**

Me kërkesën e **“Pronet” IT Konsalting, Inxhiniering, Telekomunikime, Sh.p.k.**
Prishtinë, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, lëshonë këtë :

V Ë R T E T I M

Me të cilën vërtetohet se ndaj Ndërmarrjes, **“Pronet” IT Konsalting, Inxhiniering, Telekomunikime, Sh.p.k. Prishtinë**, në bazë të evidencës në regjistrat që posedon kjo Gjykatë, nuk është inicuar procedure për delikte ekonomike, nuk është inicuar procedure për konteste ekonomike në lëndët civile, nuk është ushtruar propozim për ekzekutim, si dhe nuk kemi shenime se ndaj ndërmarrjes në fjalë ushtrohet, apo është duke u ushtruar procedure e ndalimit të veprimtarisë.

Vërtetimi i lëshohet me kërkesën e palës dhe shërben për hapje të filialës në Shqipëri, kurse për nevojat tjera nuk mund të përdoret.

Taksa është paguar sipas tarifës mbi taksat Gjygjësore në shumë prej **10 €**

**ADMINISTRATORI
MURAT PAÇARADA**





INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
QEVERIA E KOSOVËS / MINISTRIA E TRËGTISË DHE INDUSTRIË
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
GOVERNMENT OF KOSOVO / MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY



REGJISTRI I BIZNESIT KOSOVAR / KOSOVO BUSINESS REGISTRY / KOSOVSKI REGISTAR BIZNISA

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFICATE OF REGISTRATION
CERTIFIKAT O REGISTRACIJE



70041518

(Nr. i biznesit / Business No/Br.biznisa)

Pronej: EE Konsalting, Inzhiniering, Telekomunikame, Sh.p.k.

Emri i biznesit / Name of Business / Naziv biznisa

Lloji i biznesit:
Type of Business:
Tip biznisa:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Limited liability company
Društvo sa ograničenom odgovornošću

Adresa:
Address:
Adresa:

Kosova Prishtinë Prishtinë
Kosovo Pristina Pristina
Kosovo Pristina Pristina
Zona Industriale, Veternik P.n.

Data e inkorporimit:
Date of Incorporation:
Datum inkorporiranja:


01/04/2005

Data e regjistrimit:
Date of Registration:
Datum registracije:

02/09/2003

01/04/2005

Data/ Date/ Datum




Nënshkrimi/ Signature/ Potpis

INFORMATA MBI BIZNESIN
INFORMATION ABOUT BUSINESS
INFORMACIJA O BIZNISU

Numri i regjistrimit të biznesit:
Business registration number: **70041518**
Broj registracije biznisa:

Shënim me rëndësi:
Important note:
Važna napomena:

Vërtetojm se biznesi 80046260 është marr nga Enti Statistikor, dhe vepron që nga data 20-02-2001, mirpo për shkaqe teknike nuk mund të ndrrohet tipi i biznesit, kështu që ky biznes pas ri-regjistrimit vepron me numrin e ri të biznesit i cili fillon me numrin 700. (shih informatat në totalin e biznesit).

Emri:
Name:
Naziv:

„Pronet“ IT Konsalting, Inxhiniering, Telekomunikime,
Sh.p.k.

Adresa:
Address:
Adresa:

Kosova Prishtinë Prishtinë
Kosovo Pristina Pristina
Kosovo Priština Priština
Zona Industriale, Veternik P.n.

Lloji i biznesit:
Type of business:
Tip biznisa:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Limited liability company
Društvo sa ograničenom odgovornošću

Statuti/ Marrëveshja/ Deklarata/ Diçka
tjetër:

Statute/ Agreement/ Statement/ Other: Statuti më 19-06-2003. Aneks i Statutit më 25-03-2005.
Statut/ Dogovor/ Izjava/ Ostalo:

Data e themelimit:
Date of founding:
Datum osnivanja:

02/09/2003

Data e konstituimit:
Constitution date:
Datum konstituisanja:

01/04/2005

Kapitali themelues:
Founding capital
Osnivački kapital

Kapitali themelues EURO:
Founding capital EUR:
Osnivački kapital EUR:

20.000.00

Pjesa a paguar EURO:

Paid part EUR: 5,000.00
Plaćeni deo EUR:

Pronarët:
Owners:
Vlasnici:

Personat fizik:
Physical persons:
Fizička lica:

NP i personit:
Person ID: 1015780076
Matični broj:

Emri:
Name: Armend Skeja
Ime:

Adresa: Kosova Prishtinë Prishtinë
Address: Kosovo Pristina Pristina
Adresa: Kosovo Priština Priština
Kodra e Diellit, Zona e Perëndimit L-6 7

Lloji i përgjegjesisë: Përgjegjësi e kufizuar
Liability type: Limited liability
Tip odgovornosti: Ograničena odgovornost

NP i personit:
Person ID: 2015637717
Matični broj:

Emri:
Name: Valon Budima
Ime:

Adresa: Kosova Prishtinë Prishtinë
Address: Kosovo Pristina Pristina
Adresa: Kosovo Priština Priština
Dardania BL-9 , B-3 35

Lloji i përgjegjesisë: Përgjegjësi e kufizuar
Liability type: Limited liability
Tip odgovornosti: Ograničena odgovornost

Aktivitetet:
Activities:
Aktivnosti:

Aktiviteti kryesor: 7220 Këshillime dhe sigurimi i pajisjeve programore (softwar-it)
Main activity: Software consultancy and supply
Primarna aktivnost: Pružanje saveta i izrada kompjuterskih programa

Aktiviteti dytësor: 5164 Tregtia me shumicë e makinave të zyrave dhe të pajisjeve
Secondary activity: informatike
Wholesale of office machinery and equipment
Sekundarna aktivnost: Trgovina na veliko kancelarijskim mašinama i opremom

Aktivitetet të tjera:
Other activities:
Ostale aktivnosti:

3002 Prodhimi i makinave llogaritëse dhe pajisjeve të tjera për
përpunimin e të dhënave
Manufacture of computers and other information processing
equipment
Proizvodnja računskih mašina i druge opreme za obradu
podataka

7210 Ofrimi këshillash për pasjisjet llogaritëse (hardwar-it)
Hardware consultancy
Pružanje saveta u vezi sa kompjuterskom opremom

Numri i punëtorëve:
Number of employees: 25
Broj zaposlenih:

Autorizimet:
Authorisation:
Ovlašćenja:

Personat e autorizuar:
Authorised persons:
Ovlašćena lica:

NP i personit:
Person ID: 1011044367
Matični broj:

Emri:
Name: Ardian Shehu
Naziv:

Adresa: Kosova Prishtinë Prishtinë
Address: Kosovo Pristina Pristina
Adresa: Kosovo Priština Priština
Xhavit Ahmeti 124

Autorizimi:
Authorisation: Drejtor.
Ovlašćenje:

NP i personit:

Person ID: 1015780076
Matični broj:

Emri:
Name: Armend Skeja
Naziv:

Adresa: Kosova Prishtinë Prishtinë
Address: Kosovo Pristina Pristina
Adresa: Kosovo Priština Priština
Kodra e Diellit, Zona e Perëndimit, L-6 7

Autorizimi:
Authorisation: Drejtor i projekteve.
Ovlašćenje:

NP i personit:
Person ID: 2015637717
Matični broj:

Emri:
Name: Valon Budima
Naziv:

Adresa: Kosova Prishtinë Prishtinë
Address: Kosovo Pristina Pristina
Adresa: Kosovo Priština Priština
Dardania, BL-b3 35

Autorizimi:
Authorisation: Drejtor i shitjes.
Ovlašćenje:

